

VENDIM
Nr. 219, datë 11.3.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE E TË PROCEDURAVEPËR KONSULTIMIN
ME GRUPET E INTERESIT DHE PUBLIKUN, SI DHE DËGJESËN PUBLIKE GJATË
PROCESIT TË VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR¹**

(Ndryshuar me vendimin nr.52, datë 31.1.2018)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 10, të ligjit nr. 91/2013, datë 28.2.2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave për informimin, përfshirjen dhe konsultimin me publikun dhe grupet e interesit gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor (VSM).

2. Për qëllim të këtij vendimi, do të zbatohen përkufizimet përkatëse të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 91/2013, datë 28.2.2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”.

I. NJOFTIMI DHE KONSULTIMI ME GRUPET E INTERESIT PËR HARTIMIN, NDRYSHIMIN, RISHIKIMIN OSE MODIFIKIMIN E NJË PLANI APO PROGRAMI

1. Ministria, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga autoriteti propozues për hartimin, ndryshimin, rishikimin ose modifikimin e një plani apo programi, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 91/2013, datë 28.2.2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, e dërgon propozimin në formë elektronike për mendim të grupet e interesit, të përcaktuara në shkronjën “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 91/2013, dhe i njofton ato për datën, orën dhe vendin e organizimit të takimit, siç përcaktohet në vijim të këtij kreu.

2. Autoriteti propozues, në bashkëpunim me ministrinë, organizon takimin e thërret për pjesëmarrje grupet e interesit të përcaktuara në shkronjën “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 91/2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

3. Shpenzimet për organizimin e takimit mbulohe nga autoriteti propozues.

4. Grupet e interesit iadërgojnë mendimin e tyre me shkrim ministrisë, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e takimit, për nevojën ose jo të kryerjes së procesit të VSM-së për hartimin, rishikimin, ndryshimin apo modifikimin e planit ose programit të propozuar dhe, nëse ato nuk shprehen brenda afatit ligjor, nënkuptohet se nuk kanë kërkesa për propozimin.

5. Ministria, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, vendos nëse hartimi, rishikimi, ndryshimi apo modifikimi i planit ose programit duhet t’i nënshtrohet procesit të VSM-së dhe i dërgon autoritetit propozues vendimin e saj duke i bashkëlidhur edhe sqarimet e kërkesat, sipas pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 91/2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”.

6. Ministria, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit, e publikon atë në faqen e vet zyrtare të internetit, ndërsa një kopje i dërgohet AKPT-së, në formë shkresore, dhe grupeve të interesit të konsultuara sipas pikës 2 të këtij vendimi, në formë elektronike.

II. KONSULTIMI ME GRUPET E INTERESIT PËR ÇËSHTJET QË DO TË TRAJTOHEN

¹Ky vendim është përafuar pjesërisht me: direktivën 2001/42/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 27 qershor 2001, “Për vlerësimin e pasojave në mjedis të planeve dhe programeve të caktuara”, Numri CELEX: 32001L0042, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.197, datë 21.7.2001, faqe 30 - 37.

Vendimi nr.218, datë 11.3.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.40/2015

Vendimi nr.52, datë 31.1.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.11/2018

NË RAPORTIN E VSM-SË

1. Për konsultimin e grupeve të interesit për çështjet që duan të trajtohen në raportin e VSM-së, autoriteti propozues u dërgon një njoftim në formë shkresore dhe elektronikegrupeve të interesit tëpërcaktuara nëpikënl, të nenit 9, të ligjit nr. 91/2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, ku përcaktohen data, ora dhe vendi i organizimit të takimit.

2. Në njoftimpërcaktohen gjithashtu:

a) qëllimi i propozimit, shoqëruar me të dhëna të tjera të nevojshme, si: relacion shpjegues, hartat e të dhëna të tjera ndihmëse që disponon autoritetilidhur me propozimin;

b) arsyetimi për nevojën e hartimit, ndryshimit, rishikimit ose modifikimit të planit apo programit;

c) autoriteti miratues i planit apo programit;

ç) procedura që do të zbatohet për hartimin, ndryshimin, rishikimin apo modifikimin e planit ose programit, si dhe afatet kohore të para-shikuara për këtë.

3. Autoriteti propozues organizon takimin megrupet e interesit, ku prezantohet në mënyrë të përmbledhur plani apo programi i propozuar, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dërgimit të njoftimit.

4. Grupet e interesit i përgjigjen autoritetit propozues brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e takimit. Në rast se ato nuk përgjigjen brenda këtij afati, atëherë nënkuptohet se nuk kanë kërkesa të veçanta për t’u trajtuar në raportin paraprak të VSM-së, përveç atyre të përcaktuara në pikën 3, të nenit 10, të ligjit nr. 91/2013, datë 28.2.2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”.

5. Nëse grupet e interesit kanë kërkesa apo sugjerime për çështjet që duhet të trajtohen në raportin e VSM-së, ato merren në konsideratë nga autoriteti propozues gjatë hartimit të raportit paraprak dhe përfundimtar të këtij raporti ose argumentohet mosmarrja parasysh e tyre.

6. Gjatë organizimit të takimit, autoriteti propozues i dërgon njoftim ministrisë për pjesë-marrje.

III. KONSULTIMI I RAPORTIT PARA-PRAK TË VSM-SË ME PUBLIKUN DHE GRUPET E INTERESIT

1. Autoriteti propozues, pas hartimit të raportit paraprak të VSM-së, e publikon atëpër të paktën 30 (tridhjetë) ditë në faqen zyrtare elektronike.

2. Pas publikimit të raportit paraprak të VSM-së, sipas pikës 1 të këtij kreu, autoriteti propozues njoftonministrinë dhe grupet e interesit të konsultuara sipas pikës 1, të kreut I të këtij vendimi, duke i sqaruar mënyrën për t’u njohur me raportin,si dhe datën kur do të organizohet dëgjesa publike.

3. Autoriteti propozuese publikon njoftimin e përcaktuar në pikën 2 të këtij kreu, edhe nëtë paktën njëmedia audiovizive ose të shkruar lokale dhe kombëtare.

4. Dëgjesa publike organizohet nga autoriteti propozues, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të grupeve të interesit, sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij kreu.

5. Grupet e konsultuara sipas pikës 2 të këtij kreu dhe publiku, shprehin mendimet e sugjerimet e tyre gjatë dëgjësës publike dhe gëzojnë të drejtën të dërgojnëme shkrim komente pranëautoritetit propozues,brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e mbajtjes së dëgjësës publike.

6. Autoriteti propozues dokumenton procesin e konsultimit në raportin përfundimtar të VSM-së, në të cilin pasqyron reflektimin e mendimeve, komenteve e tësugjerimeve, si dhe argumenton mosmarrjen parasysh të mendimeve apo sugje-rimeve të ngritura gjatë procesit të konsultimit.

7. Zhvillimi i konsultimit me grupet e interesit dhe publikun, për raportin paraprak të VSM-së, sipas përcaktimeve të këtij kreu, është kusht i domosdoshëm që ministria të marrë në shqyrtim dhe të miratojë deklaratën.

IV. DËGJESA ME PUBLIKUN GJATË SHQYRTIMIT PËR DHËNIEN E DEKLARATËS

1. Ministria, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës për deklaratën, sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 12, të ligjit nr. 91/2013,“Për vlerësimin strategjik mjedisor”, në rast se e sheh të nevojshme që për dhënien e deklaratës të organizojë vetë një dëgjese me publikun, atëherë njofton autoritetin propozues, duke i argumentuar edhe nevojën për organizimin e dëgjësës

publike dhe duke i përcaktuar kohën e vendin.

2. Ministria, brenda 7(shtatë) ditëve nga data e njoftimit që i bën autoritetit propozues për dëgjuesën publike, kryen këto veprime:

a) njofton me shkrim dhe në formë elektronike të gjitha grupet e interesit dhe publikun, për të cilat mendon se duhet të jenë të pranishme gjatë dëgjuesës;

b) publikon në faqen e saj të internetit njoftimin për organizimin e dëgjuesës publike dhe përmbledhjen joteknike të raportit përfundimtar tëVSM-së;

c) afishon në hapësirën e informimit të publikut një kopje të njoftimit për dëgjuesën publike.

3. Autoriteti propozues, brenda 7(shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit nga ministria, kryen këto veprime:

a) njofton me shkrim dhe me-mailgrupet e interesit, të cilat janë konsultuar sipas përcaktimeve të kreut 2, të këtij vendimi, për organizimin e dëgjuesës publike;

b) përgatit prezantimin e planit apo programit që propozohet për t'u pajisur me deklaratë, i cili përmban të paktën qëllimin e propozimit, shoqëruar me të dhëna të tjera të nevojshme, si: hartat e të dhëna të tjera ndihmëse që disponon lidhur me propozimin, arsyetimin për nevojën e hartimit, ndryshimit, rishikimit ose modifikimit të planit apo programit, konsultimet e kryera deri në hartimin e raportit përfundimtar të VSM-së si dhe rezultatet e raportit përfundimtar të VSM-së;

c) u shpërndan kopje të prezantimit dhe përmbledhjes në gjuhë joteknike të raportit përfundimtar të VSM-së të pranishmëve në dëgjuesën publike;

ç) njofton subjektin fizik/juridik që ka hartuar raportin e VSM-së që të marrë pjesë në dëgjuesën publike;

d) publikon njoftimin për dëgjuesën publike në të paktën një media audiovizive ose të shkruar lokale dhe kombëtare.

4. Përfaqësuesit e ministrisë mbajnë shënime në mënyrë të pavarur për diskutimet e plota të dëgjuesës publike dhe i pasqyrojnë ato në një raport të posaçëm.

5. Në rast se gjatë dëgjuesës publike janë shprehur mendime apo sugjerime të cilat duhet të reflektohen në raportin përfundimtar të VSM-së, ministria, brenda 10 (dhjetë) ditëve, ia dërgon ato autoritetit propozues për t'i reflektuar në raportin përfundimtar të VSM-së.

6. Autoriteti propozues, pas marrjes së komenteve dhe sugjerimeve nga ministria, i reflekton në raportin përfundimtar të VSM-së ose argumenton mosmarrjen parasysh të mendimeve apo sugjerimeve të ngritura gjatë dëgjuesës dhe e dërgon raportin në ministri.

7. Ministria, pas marrjes së raportit të VSM-së, vijon procedurën për shqyrtimin dhe pajisjen me deklaratën e ministrit sipas përcaktimeve të nenit 12, të ligjit nr. 91/2013, datë 28.2.2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor".

V. INFORMIMI GJATË MONITORIMIT DHE DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Ministria, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së raportit sipas pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 91/2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor", nga autoriteti propozues, i publikon të dhënat e monitorimit gjatë zbatimit të planit apo programit në faqen elektronike të saj.

2. Me kërkesë nga grupet e interesit dhe publiku, ministria u siguron kopje të shtypura të të dhënave të monitorimit të paraqitura nga autoriteti propozues.

3. Grupet e interesit dhe publiku mund të dërgojnë mendime dhe komente për të dhënat e monitorimit pranë ministrisë.

4. Çdo grup interesi dhe publiku kanë të drejtë të ankohen ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve gjatë zhvillimit të procedurës së informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në procesin e VSM-së, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

5. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe autoriteti/et propozues/e dhe miratues/e të planeve apo programeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 prill 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama